



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

### Debat me Publikun

01Nr 06-15378/24

Klinë, dt: 08, 05 /24

## PROCESVERBAL

Nga Debat me Publikun, mbajtur, më 29.04.2024, me fillim nga ora 13:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e udhëhoqi z. Burim Hoti, shef i sektorit të Financave, ku të pranishëm ishin drejtorë të drejtoreve, zyrtarë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së, media dhe qytetarë të Komunës së Klinës.

## RENDI I DITËS

### 1. Draft-Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

**Burim Hoti, shef i sektorit të Financave:** Atëherë, përvendetje për të gjithë!

Së bashku me anëtarët e grupit punues, bazuar në Udhëzimin Administrativ, Nr 04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, hapim takimin për konsultim publik, lidhur me Draft - Rregulloren për Taksa dhe Tarifa Komunale. Siç e thotë edhe ky udhëzim, ky dokument është i publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare të komunës, për faktin se ky dokument ende është një draft. Ju mund të jepni komente, sugjerime dhe rekomandimet e juaja në mënyrë që ato të inkorporohen në këtë draft, pasi që momentin që të miratohet ky draft edhe kalohet në kuvend.

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Faleminderit, kryesues! Realisht është mirë që ju në fillim ta bëni një prezantim të plotësim ndryshimeve të kësaj rregulloreje që e keni paraparë si komision, e mandej nëse dikush nga ju të pranishmit ka diçka për të shtuar ose për të thënë, le të urdhërojë!

**Mirsad Dakaj, këshilltar i Kryetarit të Komunës:** Përshëndetje për të gjithë! Po ju njoftoj se draft-rregullorja e re është hartuar në bazë të modelit të asociacionit të komunave të Kosovës dhe e cila është aplikative pothuajse në shumicën e komunave të Kosovës, të cilat i kanë draftuar sipas nevojave dhe kërkesave të komunave respektive. Ne, duke e pasur parasysh që rregullorja e vjetër ka pasur mangësi në teknikat e përdorimit edhe në paragrafët të cilët duhet të janë, duke u bazuar me numra, me paragrafin, për shkak të aplikimit sa më të mirë të rregullores, jemi konsultuar edhe me zyrën ligjore edhe kemi ardhur në përfundim se është më mirë me bërë një rregullore të re, sesa plotësim-ndryshimin, sepse plotësim-ndryshimi do të ishte bërë, por jo në bazë të këtij modeli edhe do të kishte pasur prapë mangësi. Tash në plotësim ndryshimet, dallimet me rregulloren e vjetër, nuk i kemi të draftuara pikë për pikë, por qytetarët prej datës 17 prill kanë qenë të njoftuar për takimin që do të mbahet sot, po ashtu, kanë qenë të njoftuar edhe është e publikuar edhe draft-rregullorja në ueb-faqë të komunës. Secili qytetar, po ashtu edhe bizneset e kanë pasur qasjen në draft rregulloren e re; të gjitha pikat ku ata kanë pasur paqartësi apo mendimin se duhet të ndryshohen, kanë qenë të qasshme edhe ne deri tash e kemi marr një numër të komenteve dhe sugjerimeve për ndryshim, të cilat z.Burimi veç i ka inkorporuar.

Ne si komision i kemi pranuar dhe i kemi pasur të arsyeshme dhe i kemi inkorporuar në këtë draft rregullore, sot, veç i mirëpresim deri më datën 3 maj komentet e reja, por nuk e kemi një pasqyrë të qartë se çka është ndryshuar me rregulloren e vjetër për shkak të konsultimit me zyrën ligjore, po ashtu edhe për shkak se janë shtuar edhe një numër i ri i taksave p.sh., janë shtuar për media dy taksa të reja, për shkak se është sugjerim i asociacionit të komunave edhe është nevoja që të aplikohen taksa të reja, dmth gjitha taksat që janë bërë, janë bërë në konsultim me drejtoritë respektive. Për çdo ndryshim ne ju presim deri më datën 3 maj.

**Burim Hoti, shef i sektorit të Financave:** Atëherë, a ka dikush ndonjë koment?

**Drilon Morina, zyrtar për tatimin në Pronë:** Përshëndetje për komisionin! Desha një pyetje lidhur me taksat, lidhur me dhënien e qirave të lokaleve të komunës së Klinës. A ka ndryshuar taksa që është aplikuar deri më sot, apo është e njëjtë?

**Mirsad Dakaj, këshilltar i Kryetarit të Komunës:** Të gjitha propozimet që i kemi marr prej drejtorive respektive, të gjitha propozimet i kemi inkorporuar në draft rregullore, tash si ka ardhur propozimi prej drejtorisë, ne e kemi draft rregulloren edhe kjo është miratuar edhe në bord të drejtorëve dhe nuk është ndryshuar, çmimi është i njëjtë.

**Rexhep Rexhepi, zyrtar i Bujqësisë:** Përshëndetje për të gjithë! Mua po më intereson te certifikata e regjistrat të fermerit që është pa pagesë, e që në të kaluarën ka qenë 3 euro, çka keni bërë me këtë, a është ndryshuar?

**Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë:** Përshëndetje për të gjithë! Që në fillim, ne si drejtori i kemi analizuar dhe për shkak që me u ndihmuar fermerët, e kemi parë të arsyeshme që mos të ketë taksa  
në aplikime.

**Mirsad Dakaj, këshilltar i Kryetarit të Komunës:** Atëherë, po ju njoftoj se deri më datën 3 maj, secila drejtori me punëtorët e vet mund të bëjë propozimet e reja dhe nëse e vlerëson komisioni që janë të arsyeshme prej drejtorive respektive, atëherë ne mund ta ndryshojmë.

**Burim Hoti, shef i sektorit të Financave:** Po, drejtor?

**Enver Berisha, drejtor i FEZH:** Po e marr fjalën edhe njëherë: Realisht kjo draft rregullore ndryshimet më të mëdha i ka tekstuale, për shkak se në këtë rregullore është dashur me analizuar me nivelin qendror. Te pjesa e ndryshimeve statistikore te shifrat, ne ua kemi lënë dmth në mundësi drejtorive, ata me vlerësuar se cilën datë ose tarifë duan ta ndryshojnë. Drejtoritë kanë pasur kohë të mjaftueshme me i proceduar këto, por nuk do të thotë që sot e tutje e deri në momentin kur kjo rregullore aprovohet në kuvend, që s'mund ta propozojnë prapë me shkrim atë ndryshim që e vlerësojmë që është e domosdoshme, po është problemi edhe për qytetarët, ata që janë këtu sot, po edhe ata që nuk janë, prapë e kanë një mundësi edhe periudhë deri në aprovim me i adresuar, dmth vlerësimet e veta me shkrim, në adresë të komisionit, kështu që, nuk përfundon kjo sot në këtë debat. Kjo është një mundësi që qytetarët edhe secila drejtori duhet prapë me i dhënë sugjerimet e veta, por kjo vazhdon, dmth deri në moment të aprovimit të rregullores të gjithë prapë kanë mundësi me i linçuar orientimet e veta dhe komisioni me i pasur parasysh deri në momentin e aprovimit në asamble.

**Burim Hoti, shef i sektorit për Financa:** Faleminderit, drejtor! Atëherë, a ka dikush tjetër?

**Gazmend Bojaj, drejtor i QKMF-së “Nënë Tereza” në Klinë:** Ne kemi diskutuar me drejtorin për Shëndetësi, edhe meqenëse nuk qenka ai këtu, atëherë po e marr fjalën. Tarifat dhe pagesat të cilat bëhen brenda QKMF-së, i kemi shqyrtuar në detaje që mos me u dëmtuar qytetari, edhe kemi ardhur në përfundim që, përvèç dy certifikatave të cilat e kanë një tarifë të lartë, edhe mandej e kemi shqyrtuar edhe me zyrtarin ligjor, për shkak se pagesa e tyre është

50 euro.

Prapë se prapë, kanë mbetur ato dy certifikata në atë pagesë për shkak se e njëjta kryhet edhe nivel të krejt Kosovës, dmth gjitha tarifat tjera të cilat kërkohen për ndryshim, dmth janë të bazuara në kujdesin parësor, shëndetësor në Kosovë; qysh kryhen pagesat në kujdesin parësor, shëndetësor nëpër institucione, QKMF, QMF apo AMF, dmth karshi atyre pagesave i kemi dërguar edhe ne tonat, prandaj kishte qenë mirë me aprovuar edhe ashtu si pako qysh janë, për shkak se nuk e dëmtojnë qytetarin e Klinës.

Kemi tentuar me çdo kusht, që me qenë të njëjta në nivel të Kosovës, por në asnje mënyrë me dëmtuar qytetarin, edhe po shpresojmë që kemi me shqyrtuar drejt edhe saktë, faleminderit, diçka tjetër

nuk kam!

**Burim Hoti, shef i sektorit për Financa:** Faleminderit, drejtor! Ne e kemi udhëzimin për draft çka kemi me ndryshuar, direkt me shkrim nuk na ka ardhur prej QMF-së. Tash, ju çka i keni për ndryshim, kohë keni deri më 3 maj, mund t'i dorëzoni edhe tanë komisioni i shikon nëse janë në rregull,

apo

jo.

Nëse s'ka më pyetje po e përfundojmë. Faleminderit që gjetët kohë të vini!

Procesmbajtësja,  
Monika Palushi



Kryesuesi,  
**Burim Hoti**